

Shkodër, më 09 Maj 2018

FTESË PËR SHPREHJE INTERESI

Emri Acli Ipsia në Shqipëri
Adresa Rruga “Palokë Kurti”, Nr.1, Shkodër
Tel/Fax +355 (0) 68 4072096
E-mail acliscutari@gmail.com

Titulli: Ftesë për shprehje interesi nga kompani ndërtimi shqiptare dhe të huaja për të realizuar punime ndërtimore me objekt “Ndërtimi i Shtëpise familje”.

Nr. Referencës: 10950

Acli Ipsia në Shqipëri në kuadër të projektit “Komuniteti i të ardhmes: ndërhyrje të përfshirjes sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodrës” AID 10950, të financuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS) do të përdorë një pjesë të buxhetit të projektit për të realizuar punime ndërtimore me objekt “Ndërtimi i Shtëpisë Familje”.

Projekti përfshin ndërtimin e një objekti banimi dy katësh.

Ne synojmë në përzgjedhjen e një firme kompetente dhe të besueshme për të realizuar ndërtimin e këtij objekti.

Periodha e zbatimit të kontratës do të jetë afërsisht 5 muaj nga nënshkrimi i kontratës, periudha e cila do të saktësohet nga projekti.

Acli Ipsia në Shqipëri fton kompani sipërmarrëse ndërtimore që plotësojnë kriteret e parashtruara në aneksin bashkëngjitur, të shprehin interesin e tyre në ofrimin e këtyre punimeve.

Operatorët ekonomikë të interesuar duhet të japin informacion në shprehjen e interesit që paraqet kualifikimet dhe eksperiencën e duhur për realizimin e këtyre punimeve.

Theksojme qe keto kritere nuk jane perfundimtare, por sherbejne per te perzgjedhur kompanite te cilave, do t'u dergohen DST finale per te qene pjese e tenderit te "ndertimit te shtepise familje.

Vetem kompanive qe shprehin interesin ne kete faze do t'u dergohet dokumentacioni final per te marre pjese ne tenderin e ndertimit te shtepise familje.

Shprehjet e Interesit duhet të dorëzohen në kopje të printuar ose elektronike në adresene emailit: aclicutari@gmail.com ose ne adresen: Acli Ipsia ne Shqiperi, Rr. Paloke Kurti, 1 - 4001, Shkoder, brenda dates 18 Maj 2018 dhe të shënohet qartë:

"Shprehje Interesi për punimet e objektit "Ndërtimi i shtëpisë familje" në kuadër të projektit: "Komuniteti i të ardhmes: ndërhyrje të përfshirjes sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodrës" AID 10950.

Bashkëlidhur gjeni kriteret qe duhet te plotesojne paraprakisht kompanite qe duan te shprehin interesin.

Për Autoritetin Kontraktor

Acli Ipsia në Shqipëri

Kordinator per Ballkanin




Daniele Socciarelli

ANEKS 1

KRITERET PER SHPREHJE INTERESI

OBJEKTI: “NDËRTIM I SHTËPISË FAMILJE”

PROJEKTI: “Komuniteti i të ardhmes: ndërhyrje të përfshirjes sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodrës” AID 10950”, i bashkëfinancuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS), si dhe i implementuar nga Istituto Pace Sviluppo Innovazione ACLI.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Kandidati/Ofertuesi duhet te plotesoje:

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

- a) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional,

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 11 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore.

Në rastin kur kandidati/ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, në vend të Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, do të paraqitet vendimi i Gjykatës për regjistrimin si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

2. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

- a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
- b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore deri ne Prill 2018 të lëshuar nga Administrata Tatimore.

3. Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionale ose tregtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, për këtë kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të plotësojë:

- a. Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;
- b. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- c. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- ç. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- d. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 8;
- dh. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9

e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ne lidhje me vlerësimin e gjendjes ekonomike e financiare të kandidatit/ofertuesi duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer xhiro mesatare vjetore për vitet 2015, 2016 dhe 2017 në një vlerë prej 150.000 mijë euro.

Ne plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Vërtetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë viteve të sipërpermendura.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2015, 2016 dhe 2017.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri deri në muajin Prill 2018.

Mosshyerja e detyrimeve te energjise elektrike perben shkak per skualifikimin e operatorit ekonomik, pervec rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara te energjise elektrike, te konfirmuara ne vertetimin e leshuar nga furnizuesi, jane ne proces ankimimi ne Gjykate. Furnizuesi i energjise elektrike eshte i detyruar qe ta leshoje kete vertetim jo me vone se 5 (pese) dite nga data e depozitimit te kerkeses se nga operatori ekonomik.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje dokument qe verteton se (Subjekti juaj) ka paguar taksat vendore per vitin 2017 leshuar nga administrata lokale per te gjitha vendet ku ushtron aktivitet shoqeriasipas ekstraktit te QKR

2.2 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pervoje te suksesshme ne ekzekutimin te pakten:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetme në një vlerë prej 75.000 euro (vlera do te saktësohet nga projekti), të ekzekutuar gjatë tre viteve te fundit te aktivitetit te tij; Nese operatori paraqet nje kontrate bashkim operatoresh kjo vlere duhet te plotësohet sipas perqindjes se operatorit te percaktuar ne kontraten e bashkepunimit.
- b. Punë të ngjashme ku vlera totale e punëve të ekzekutuar gjatë tre viteve te fundit te aktivitetit te tij, te jete ne një vlerë prej 450.000 mije euro.

2. Lidhur me këtë pikë ofertuesi te paraqese:

3. Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me liçense profesionale leshuar nga organet perkatese, e cila te permbaje minimumi kategorite e meposhtme. (Nese operatori eshte i pajisur me licenca profesionale qe permbajne kategori me te larta –niveli B, C, D nenkupton kompani me eksperience me te mire)

- | | |
|--|----------------------|
| > N.P-2 Ndërtime civile dhe industriale. | Niveli i shoqërisë A |
| > N.P- 3 Rikonstuksion dhe mirembajtje godinash. | Niveli i shoqerise A |
| > N.P - 11Ndertime per N/Stacionet, kabinat... | Niveli i shoqerise A |
| ➤ N.S. 1 Punime per prishjen e ndertimeve | Niveli shoqerise A |
| ➤ N.S. 2 Impiante hidrosanitare... | Niveli shoqerise A |
| ➤ N.S. 4 Punime rifiniture... | Niveli shoqerise A |
| ➤ N.S. 12 Impiante Teknologjik... | Niveli i shoqerise A |
| ➤ N.S. 14 Impiante te brendshme, elektrike.. | Niveli shoqerise A |
| ➤ N.S 18 Punime gjeodezike | Niveli shoqerise A |

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet te kete numrin e nevojshem te punonjesve për realizimin dhe zbatimin e kontrates. Numri mesatar vjetor i punonjesve të siguruar për periudhen: Janar – Dhjetor 2017 dhe Janar - Prill 2018 duhet te jetë 40 (dyzet).

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese vertetim te leshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetsore ne te cilin te jete i percaktuar numri i punonjesve te siguruar per secilen nga periudhat e mesiperme, shoqeruar me listepagesat perkatese E-Sig, per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore.

5. Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar te pakten

- 1 inxhinier ndërtimi
- 1 inxhinier elektrik
- 1 inxhinier mekanik
- 1 inxhinier topograf

Inxhinieret duhet te jene te siguruar dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-Sig.

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: a) Kontratat individuale te punes, dhe b) Diplomat, dhe c) CV-te, dhe d) Librezen e Punes, te inxhinierëve te mesiperme.

6. Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij nje ekspert te licensuar per mbrojtjen kundra zjarrit nga organet kompetente. Ky punonjes duhet te jete pjese e stafit te shoqerise.

7. Operatori Ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme, si me poshte:

- ISO 9001:2008 mbi "Sistemet e menaxhimit cilësisë",
- ISO 14001:2004 mbi "Sistemet e menaxhimit ambjentit"
- BS OHSAS 18001:2007 mbi "Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë"
- ISO 50001:2011 mbi "Sistemet e menaxhimit te energjise",
- ISO SA 8000:2014 – SOCIAL ACCOUNTABILITY MANAGEMENT SYSTEM